



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Z È D H È N È S I**

Tiranë, më 27/09/2014

*Njoftim për Shtyp*

**KLSH KALLËZON NË PROKURORI ISH DREJTORIN E PORTIT DETAR SH.A.**  
**SARANDE DHE ISH DREJTUES TË TJERË TË TIJ**

Kontrolli i Lartë i Shtetit përfundoi auditimin në “Portin Detar” Sh.a. Sarandë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në procedurat e prokurimeve, zbatimin e kontratave si dhe zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien me qira të ambienteve”, për periudhën e veprimtarisë në vitet 2011-2013..

Nga ky auditim, u konstatuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore në tenderat për investime dhe në dhënien me qira të ambienteve, si:

1. Në tenderin me objekt: “*Riparim dhe montim i vinçit Ganz për shërbime portuale*”, me fond limit 6.000.000 lekë, u konstatuan:
  - a. Dosja e këtij tenderi është e pa inventarizuar dhe e pa arkivuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”. Në dosje nuk disponohet asnjë dokumentacion mbi domosdoshmërinë e kryerjes së këtij punimi, nuk ka asnjë urdhër nga titullari i Autoritetit Kontraktues, për përcaktimin e zyrtarëve që do të hartojnë përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2, “Llogaritja e vlerës së kontratës”, pika “ç”;
  - b. Nuk ka asnjë të dhënë për mënyrën e llogaritjes së fondit limit;
  - c. Nuk disponohet asnjë skicë, vizatim e projekt për montimin e vinçit, nuk ka asnjë preventiv analitik të punimeve që duhet të kryhen, nuk ka asnjë të dhënë se çfarë pjesësh do të riparohen dhe se çfarë artikuj të rinj do të blihen, çfarë parametrash specifike duhet të kenë ata, nuk ka asnjë të dhënë se si kanë dalë çmimet e përcaktuara për llogaritjen e fondit limit. Hartimi i këtij preventivi në këtë mënyrë është në kundërshtim me VKM nr 514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 2, 3, 9, dhe 11 Udhëzimin nr.2, të Këshillit të Ministrave, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”;
  - d. Me shkresën nr.191, datë 31.10.2012, me lëndë: “Ftesë për pjesmarrje në tender”, nga ana e ish Drejtorit të “Portit Detar” Sh.a. Sarandë, është bërë përcaktimi i pjesmarrësve në tender, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”;
  - e. Nuk ka asnjë procesverbal të njësisë së hartimit të Dokumentave të Tenderit, për përcaktimin e pjesëmarrësve në këtë tender si dhe asnjë burim informacioni se pse janë përzgjedhur këta pjesmarrës.;
  - f. Nuk ka asnjë procesverbal të punës së komisionit për të pasqyruar ofertat ekonomike të pjesëmarrësve në tender, si dhe asnjë përshkrim mbi dokumentacionin e paraqitur në tender

nga operatorët ekonomikë. Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nuk ka asnjë dokumentacion të firmosur prej tyre mbi rezultatet e tenderit.

2. Në tenderin me objekt: *“Zmontim dhe transport elektrovinçi nga porti i qytetit në Portin e Limjonit”*, me vlerë 5,285.000 lekë, u konstatuan:

a. Preventivi i punimeve është hartuar pa u bazuar në manualët e çmimeve. Zërat dhe çmimet e tij janë në total të pa specifikuara dhe proceset e punës që do të kryhen janë të pandara në mënyrë analitike;

b. Në dosje nuk ka asnjë urdhër se kush do të merret me përlogaritjen e vlerës së kontratës;

c. Nga ana e ish Drejtorit të “Portit Detar” Sh.a. Sarandë, është bërë përcaktimi i pjesëmarrësve në tender në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 1, “Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim”, pika ”a”.

c. Nuk ka asnjë procesverbal të punës së komisionit për të pasqyruar ofertat ekonomike të pjesëmarrësve në tender, si dhe asnjë përshkrim mbi dokumentacionin e paraqitur në tender nga operatorët ekonomikë. Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk ka asnjë dokumentacion të firmosur prej tyre mbi rezultatet e tenderit.

d. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik fitues rezultoi se nuk plotësonte disa kërkesa për kualifikim.

e. Nga auditimi i dokumentacionit të raporteve të punës për kryerjen e pagesave, për vitin 2011, rezulton se disa punonjës kanë punuar për nevoja të çmontimit të vinçit në një kohë që ky vinç për t`u çmontuar është kontraktuar me operatorin fitues të tenderit.

3. Për shtesën e punimeve në kontratën me objekt, *“Ndërtim i rrethimit të Portit të Limjonit”*, është likuiduar shuma **27 muaj më vonë nga përfundimi i kontratës bazë**. Për këtë volum punimesh nuk ka asnjë dokumentacion sipas kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 12.

4. Për dhënien me qira të ambienteve të SH.A. “Porti Detar” Sarandë, mungon dokumentacioni ligjor, i përcaktuar në VKM nr.529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Në të gjitha kontratat e nënshkruara, mungon garancia e kontratës, Kreu II, pika 14, “Proceduarat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”, i VKM së mësipërme, ku citohet se “Para nënshkrimit të kontratës së qirasë, qiramarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e 3 muajve të pagesës së qirasë. Garancia ngurtësohet deri në fund të kontratës. Po kështu, nga Sh.a. “Porti Detar” Sarandë nuk është kryer monitorimi i kontratave.

Si pasojë e mosarkëtimit të detyrimeve për sipërfaqen e dhënë me qira në ambientin e terminalit të pasagjerëve me objekt “Klub tregtimi në katin e dytë”, SH.A. “Porti Detar” Sarandë i është shkaktuar një **dëm ekonomik prej 1,967,064 lekë**.

Për këto shkelje dhe shkelje të tjera të konstatuara, **KLSH ka kallëzuar në Prokurori** me Nr. 607/6 dt. 15.09.2014, **T.K., ish Drejtor i Portit Detar Sh.a. Sarande, M.M., ish Kryetar i Deges se Programimit dhe Investimeve, Th.Th., ish Kryetar i Deges Teknike dhe Th.M., normist, inspektor kalate**, për konsumimin e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera dhe ankande publike”, Neni 248 dhe Neni 258 i Ligjit Nr. 7895 date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. KLSH i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë materialet e auditimit dhe të gjitha provat përkatëse.

KLSH ka rekomanduar 37 masa organizative dhe 6 masa për shpërblim dëmi në vlerën **3,928,224 lekë**.

Gjithashtu, KLSH i ka kërkuar Këshillit Mbikqyrës të Portit Detar Sh.a. Sarandë **zbatimin e masës disiplinore “largim nga puna” për Drejtorin e tanishëm të Portit, pasi ka lidhur kontrata me tragetet e linjës, pa kërkuar asnjë dokumentacion nga shoqëritë e transportit detar si edhe pa përcaktuar në asnjë rast sanksione për likuidimin e detyrimeve në kohë, duke sjellë debitorë në rritje për Portin; ka lejuar ushtrimin e aktivitetit të shoqërive që kryejnë aktivitetin e transportit të pasagjerëve, pa u licencuar më parë; ka lidhur kontrata për pranimin dhe përpunimin e trageteve, me bazë juridike të shfuqizuar; ka dhënë urdhra për ndryshimet dhe përcaktimin në pagat e punonjësve, pa marrë miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, etj. KLSH ka kërkuar zbatimin e masës disiplinore “largim nga puna” edhe për 3 punonjës të tjerë të Portit.**